

## INTERVISTË ME BESA KRAJKU

Prizren | Data: 1 gusht, 2018

Kohëzgjatja | 24 minuta

Të pranishëm:

- Besa Krajku (E intervistuari)
- Fitore Rexhepi (Intervistuesja)
- Elmedina Arapi (Kamera)

*Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:*

*() - komunikim emocional*

*{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste*

*Simbole të tjera në transkriptë:*

*[ ] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin*

*Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.*

## **Pjesa e parë**

**Fitore Rexhepi:** A mundeni me u prezantu në fillim, me na tregu ku keni lind, e kur keni lind edhe një pjesë t'fëminis t'juj çka ju kujtohet ?

**Besa Krajku:** Unë jam Besa Krajku, jam e lindur me 18 mars 1952, kam lindur në Suharekë, aso kohe babi im ka qenë msus [mësues]. Ne jemi pesë fëmijë, tre vllazën edhe dy motra. Vëllau i madh ka lind në Prizren në 1950-shin. Pastaj babai me dekret është caktuar kryeshef i arsimit n'rajonin e Suharekës kështu që unë kam lind në Suharekë. Nuk më kujtohet koha kur kanë jetu në Suharekë u kon një kohë e shkurtër ka qenë dy vite apo një vjet e gjys, mandej prej Suharekës kam kalu në Pejë domethon fëminia në Pejë më kujtohet, deri në moshën pesë vjeç e gjys kemi qenë në Pejë, meqenëse edhe nanën e kam pas Pejane ashtu që kam mjaft kujtime prej Pejës edhe prej kushërive prej tezeve. Në vitin 1958 babai përsëri është shpërngul prej Pejës në Prizren edhe kemi vazhdu në Prizren mo nuk...

**Fitore Rexhepi:** Këtu e keni fillu shkollën fillore apo ?

**Besa Krajku:** Shkollën fillore e kam fillu në Prizren në vitin '68, në shkollën fillore "Mustafa Baku", kom ardh pak me vonesë ndoshta një muj vonesë, kishin fillu mësimet ne kur erdhëm kështu që më kujtohet mësuesja Nimete Kabashi ka qenë një pedagoge e shkëlqyeshme, një zonjë e respektume fatkeqësisht e ndjera shpejtë ka ndrru jetë, nuk është ma në mesin e të gjallëve, më vonë mandena m'ka ra me ndëgju shumë për biografinë e saj për meritat e saja, vjen prej një familjes patriotike, arsimdashëse. Thash babai im ka qenë mësues edhe me profesion por edhe në shtëpi disi jemi rritur me ato ndalesat çka bon e çka sbon, çka duhet e çka s'duhet ajo ka qenë shumë normale.

**Fitore Rexhepi:** Ka dhanë mësim një herë në Pejë mandej në Prizren apo ?

**Besa Krajku:** Po, po babai im ka qenë gjakovar por familja e tij u dëbu në '36-shin prej Gjakove në Shqipëri , gjyshja jeme me tre fëmijë, me dy fëmijë, me tre fëmijë, babain dy hallat natën e kanë dëbu edhe halla e tretë ka lind në Letaj të Shqipnisë.

**Fitore Rexhepi:** Pse i kanë dëbuar ?

**Besa Krajku:** I kanë dëbuar se babgjyshi ka qenë në Lëvizjen Kaçake<sup>1</sup> kështu që jo vetëm familjen e gjyshës por edhe një numër të familjeve prej Gjakovës i kanë dëbuar për në Shqipëri aty ku i ka pasë kryefamiljarët, por gjyshi ka vdekur mandej në Durrës, babai im ka regjistruar Shkollën Normale të Elbasanit. Deri sa ka qenë nxënës i Shkollës Normale ende pa diplomë i ndjeri Mehmet Xhevori drejtor aso kohe i Shkollës Normale të Elbasanit i mbledhi të gjithë nxënësit e vetë kosovarë me diplomë e pa diplomë edhe i sjell në Kosovë me e përhap arsimin, kështu që edhe baba ka qenë në mesin e atyne. Më kujtohen shokët e babës të cilët kanë qenë bashkë, ka qenë Sami Raqa, Mazllum Raqa, Meleqe Raqa na me ta jemi përzi edhe familjarisht tanë jetën edhe me fëmijët e tyre jemi shoqëruar me shumicën kemi qenë edhe në gjeneratë kështu që vazhdimisht bashkë.

Po që babai kur vjen prej Shqipërisë fillimisht vendoset në Prizren në shtëpinë e gjyshës, gjyshja ka qenë prizrenase e ka pasë shtëpinë tash ku është Kuvendi Komunal aty, Qoraga i thojnë, po. Edhe e caktoi ndërkohë në Suharekë kryeshef të arsimit. Ka qenë një ndër mësuesit e parë, i ka mbajtur gjithë ato fshatëra edhe themeluesi i shkollës në Peqan edhe drejtori i shkollës. Më kujtohet se dy herë ajo shkollë u kallë [djeg], edhe gjatë Luftës Dytë [Botërore], edhe kështu që ai ka marrë pjesë në renovimin, rindërtimin e asaj shkolle dy herë edhe këtë luftën e fundit më kujtohet kur erdhën tash punëtorët e arsimit e ftun atë ditë kur u hap shkolla përsëri. Në Pejë fëmijërinë e kam kalu ma tepër me kusheri me moshatarë, me... a në Prizren kam kujtime shumë të mira, prej shkollës kam pas shoqet e klasës prej vitit të parë edhe ende i kam shoqe, që na ka afër mentaliteti botëkuptimi ashtu kanë qenë...

**Fitore Rexhepi:** E në gjimnaz ku keni qenë ?

**Besa Krajku:** Gjimnazin në Prizren nisoj e kom kry, me qato shoqe të shkollës fillore kemi qenë edhe në gjimnaz, shumica prej tyre mos me thonë 90 për qind kemi shku në fakultet, jemi ndoshta gjenerata e parë, të gjitha femna shkuan në fakultet, dy apo tri shoqe të gjeneratës për arsye të ndryshme nuk patën mundësi mu largu prej Prizrenit por i kanë kry nga dy shkolla të larta, që konkurrenca ka qenë ashtu një konkurrencë pozitive mirëpo kanë qenë qenë mjaftë ambicioze, dhe të gjithat kanë diplomë, ende kontaktojmë, ende shifemi kohë pas kohe, tash shumica janë të penzionume prej tyre.

Kom pas fatin me pas profesorët, pedagogët të mirë qysh prej shkollës fillore, shkollë të mesme gjithashtu në fakultet. Fakultetin Juridik e kam regjistru në vitin '70 në Prishtinë, kom diplomë '75-shin. Kom pas fatin me e pas profesor të historisë Ali Hadri, profesor Ejup Statovcin, rektorin Esat Stavilecin, Gazmend Zajmin, Bardhyl Çausin, po thom një grup të madh profesorëve të cilët aso kohe ose ishin duke doktoru ose vetëm kishin doktoru, kush në Zagreb kush në Sorbonë kështu që ka qenë kënaqësi me qenë student i tyre.

**Fitore Rexhepi:** Qysh ju ka dukur juve kur keni kaluar prej shkollës së... domethon jetën e keni pasë në

<sup>1</sup> Lëvizja Kaçake lindi si formë e rezistencës kundër pushtuesve të huaj. Me këtë emër njihet në periudhën turke në shekullin XV-XVI, e cila kishte më tepër karakter ekonomik se sa politik.

Prizren , shkollën fillore, të mesme... Mandej gjimnazi ka qenë i përgjithshëm?

**Besa Krajku:** Gjimnazi ka qenë i përgjithshëm, po.

**Fitore Rexhepi:** Qysh ka qenë me u përshtat me juridikun mandej me drejtësinë? Jeta në Prishtinë, plus studimet?

**Besa Krajku:** Jeta në Prishtinë ska qenë e lehtë për ne se kushtet materiale ishin të vështira. Na ishim me ni pagë, baba ishte mësues, mirëpo si njeri arsimdashës na ka dhanë mundësinë të gjithëve. Fjala e parë e tij ka qenë mësoni, nëse ka nevojë edhe setrën e shes mundësinë ju jap me një kusht që s'guxoni me ja hup shancën tjetrit, domethonë mësoni se... Se ishim ne pesë fëmijë, kishim diferencë nga dy vjet, mbas dy vjete vike tjetri edhe kështu që u duheshe me pasë kujdes (qesh).

Kur shkova në fillim nuk kisha domethonë baba më financoj, po në provim vitin e parë drejtë ekonomike më kujtohet ishte profesori Neshid Zhupi, pata fat ashtu qëlluan pyetjet me të vërtetë shumë të mira ashtu se njeri kajherë të duhet edhe fati të ndihmon, ai u nda shumë i kënaqur edhe më pyeti "A ki kredi?" thash, "Jo profesor", tha, "Apliko". Ai ishte kryetari i komisionit për kredi të studentëve, kështu që aplikova e fitova kredinë. Ndërkohë pasi e kryva vitin e parë e kisha notën mesatare të madhe, fitova edhe bursin e universitetit, bursa e unversitetit atëhere ishte kogja e madhe, për mu gati se sa një pagë, kështu që isha e kënaqur edhe unë edhe familja.

**Fitore Rexhepi:** E qysh keni vendos me studiu për drejtësi?

**Besa Krajku:** Skom mendu fillimisht për juridikun, kam pas dëshirë mjekësinë, psikologji industriale, jom kthy atyre degëve pak që ishin... Por psikologjia industriale ishte në Zagreb, mundësitë nuk i kisha, vëllau i madh studiojke në Novi Sad kështu që ishte e vështirë pak edhe pse nana u mendojke me punëdore me kontribu mjaftë, por ishte e vështirë. Mjekësia ishte konkurrencë e madhe, te gjenerata e parë që u hap mjekësia kështu që u orientova për fakulltetin juridik edhe nuk jam pendu. Kam filluar me punu ende pa diplomu, me 1 nandor të vitit '74 u punësova se ndërkohë shkuan edhe dy vëllezër në fakulltet kështu që u duhke me kontribu po. Mirëkuptim, kështu që kom punu dhe e kom dhonë komplet vitin e katërt gjatë punës.

**Fitore Rexhepi:** Jeni kthyer me punu këtu në Prizren?

**Besa Krajku:** Në Prizren jam kthy me punu, po në Prizren jam kthy me punu. Kam punu në një ndërmarje ekonomike që kishte nevojë me përfaqësu ato kontestet ekonomike të vlerave të mëdha, në krejt Jugosllavinë. Shumë shpesh në Gjakovë e në Prishtinë ku ishte Gjykata Ekonomike mirëpo shpesh edhe jashtë Kosovës në Zagreb, Sarajevë...

**Fitore Rexhepi:** A ka qenë e vështirë?

**Besa Krajku:** Ka qenë sfidë, ka qenë e vështirë mirëpo nuk jam dorëzu kurrë disi më vike turp... S'është se skam pasë frikë me shku se vyshe me udhëtu natën me tren e krejtë, por ja dilsha disi dhe

në fund përfundojke krejt mirë se edhe atje kur shkojsha hassha në mirëkuptim, më kujtohet në Zagreb ka qenë viti '75, pata shku ishte një kontest i madh ekonomik, patëm problem ishte dimër ftohtë, dy ditë zgjati udhëtimi.

Kur arrita atje n'Gjykatë Ekonomike përfaqësuesja e ndërmarrjes me të cilën me të cilin ne kishim kontestin ekonomik ishte femër, gjyqtarja ishte femër, dy porote ishin femër, me një mikëprtje shumë të ngohëtë, u krye ajo shka pat, shka ishte në program mandena në kohën e lirë u shoqnum, kalum, kështu që kam kujtime të mira prej punës. Aty punova dy vite e gjysëm, ishte pak punë e randë se vazhdimisht vysha me udhëtu edhe çështja ekonomike më tepër, unë kisha nevojë me i provu të gjitha punët nga pak. Ndërkohë në bankë u punësova si bashkëpunëtore profesionale, në bankën e Kosovës në Prizren.

**Fitore Rexhepi:** Ku ka qenë?

**Besa Krajku:** Banka e Kosovës ka qenë ku është tash NLB<sup>2</sup>-ja në qendër, aty si bashkëpunëtore profesionale, mendoj se ka qenë janari i vitit '77 po më duket , apo '70... Po '77. Po në bankë nuk kishte punë unë isha mësu me një tempo... Por ato punë që ishin të parapame u kryen shpejtë, i quam vërejtje do kredimarësve, erdhën i kryen obligimet e veta edhe ishte një punë mjaft e qetë. Mbas tre muajve erdh Kryetari i Gjykatës Komunale në Prizren aso kohe ka qenë Xhemil Sela, po. Erdh me bisedu dhe më tregoi se në nivel të Kuvendit Komunal ka pasë një komision kadrovik ju thojshin, edhe ata vlerësojshin kuadrat cilat janë cilat munden po edhe komisioni kadrovik në nivel të kuvendit tha “Ka vendos me ju propozu për gjyqtare, gjykatën...”. U befasova, kishte më shumë se tre muj që punojsha këtu dhe më vike pak keq prej kolektivit këtu se shkova te drejtori me, bisedova pak me zavendës drejtorin me drejtoreshën e kredive, veç shko në gjykatë më thojshin.

Shkova te drejtori me bisedu po më pyet “Shkaku, a është paga?”. Paga ishte më e madhe aso kohe në bankë se sa në gjykatë, ishte njëfarë dallimi por i thashë, “Jo nuk është paga në pyetje” thashë “por këtu nuk ka punë”, thash, “këtu” thash, “janë njerëzit kryesisht të ngritur të gjithë po i dijnë të drejtat e veta” thash... Kështu që, “Ehh” tha, “nëse kërkon punë atëhere lirisht shko”, thashë “Unë vetëm kam ardh me ju njoftu” thash “edhe mendimi ju”, tha “Lirisht shko nëse po kërkon punë”. Kështu që shkova në gjykatë, m’emnun [më emëruan]. Kuvendi Komunal atëhere emnojke gjyqtarët e Gjykatës Komunale më thonë ‘77-shin muajin prill u emërova si gjyqtare.

**Fitore Rexhepi:** A ka qenë e vështirë?

**Besa Krajku:** Spo di, s’ka qenë i vështirë se kur shkojsh hasshe në kolegë të cilët ishin të gatshëm me të ndihmu me të mirëpritë kështu që me ta kalojshim shumë mirë. Ne ishim dy femra, unë edhe “Fetije Haxhimaxhuni”

**Fitore Rexhepi:** Qysh ju kanë pritë femrat?

---

<sup>2</sup>Banka NLB - National Lotteries Board

**Besa Krajku:** Na kanë pritë shumë mirë, na kanë pritë shumë mirë, muj me ju thonë që deri në pensionim unë kurrë nuk e kam ndi atë presionin që jam femër ose mosbesimin prej popullit. Une personalisht nuk kam pas qasi ndjenje, mirëpo edhe unë kurr s’jam... gjatë punës... Jam mundu mu sillë si njeri i profesionit, gjinia ska rëndësi. Në ndërdije vazhdimisht e kam pas ato që nuk guxoj me korrit as gjininë as profesionin me ju thanë të drejtën, sidomos kur dilsha jashtë Kosovës kur shkojsha në Zagreb, e kam zotnu mirë gjuhën sërbo-kroate, neve atëherë në shkollë e kemi pasë edhe si landë edhe kam lexuar mjaft në shkollën e mesme literaturën e kam lexuar se atëherë klasikët romanet nuk i kemi pasë në gjuhën shqipe, pak kishim, kështu që në atë kohën moshën kur lexon më së shumti kam kaluar në bibliotekë, më kujtohet si bibliotekë “Haxhi Krasniqi” po më duket ka qenë atëhere shkojshim shpesh, biblioteka e qytetit, po por kisha literaturë mjaft edhe në shtëpi se edhe hallën e kam pas mësuese, kështu që librat kishin ngel aty në shtëpi.

Halla jeme njejtë me babën ka punu në Suharekë, gjashtëmbëdhjetë vjeçe u bo mësuese, mësuesi motrën e vetë ja ka ndërpre shkollimin e ka marr me dhanë mësim, e tre muaj të verës pastaj e ka regjistru në Shkollën Normale të Gjakovës për me qenë shembull edhe për familje tjera, me i dërgu motrat. Ajo hallë edhe në Pejë njësoj me ne ka qenë ka punuar si mësuese kanë qenë edhe në teatër, në teatrin amator të Pejës edhe baba edhe halla bashkë. Halla u martu mandej në Strugë prej Pejës edhe në Strugë ka punuar si mësuese e në vitin 2000 ka vdekë, por krejt Struga e ka njoftë si mësuesja e Kosovës. Kam qenë shume e lidhur me atë hallë, e kam pasë hallë, shoqe shumë kam pas afërsi edhe ende më ka ngel afërsia me fëmijët e saj, edhe burri i saj ka qenë pedagog kështu që i kemi pas për zemër ti quaj ashtu, kemi kontakti mjaftë, kemi kontakti mjaftë, kanë ardh shpeshë e kemi shku, e qështu kjo është periudha deri në gjykatë. Në gjykatë punova një vjet, mandej erdh drejtori i bankës...

**Fitore Rexhepi:** Ku keni punuar më herët apo?

**Besa Krajku:** Ku kam punuar më herët, tha, “E di” tha, “kur ke ardh në gjykatë m’ke thonë se nuk ka punë, ke kërkun punë”, tha “tash kam ardh me të ofru punë”. Thash, “Unë qe një vit jam duke punuar këtu po tha vetëm ma kanë besu formimin e qeverisë në Prizren”, ishte atëherë kryetar Salajdin Skeja, më duket ishte i propozuar për kryetarë të këshillit egzekutiv Esat Hafëzi edhe tha, “Po e formojmë qeverinë e mendoj” tha se ai normal edhe këta tjerët, “kishte me qenë e përshtatshme ti me e udhëheqë sekretariatit për administratën e përgjithshme”. Përsëri u ngushtova çka me bo, por i kisha kolegët aty u konsultoheshim, ishte emërim me mandat katër vjeçar edhe e ruajshe të drejtën e kthimit në gjykatë aty ku kishe punu.

Në aso kohe ishte gjyqëtar edhe një ish sekretar i atij shërbimi Fevzi Hoxha më tha veç me shku, tha, “Ky vend të pret po” tha, “na kemi nevoj atje për njerëzit tanë edhe për femra”. Kështu që me propozimin e tij edhe edhe ca kolegëve tjerë aty gjyqtarë më thanë vetëm me shku. Shkova atje, tash atje kisha di çka tjetër, këtu deri sa punova, punova kryesisht me të mitur, me delikuent e mitur, atje tash vetëm e kisha çështjen administrative me mandat katër vjeçar, ka pas punë mjaft kuvendi u mendojshim njëfarë risie diçka me bo.

Më kujtohet u mendojshim administratën pak me e reformu, atëhere i kishim marr dy automjeta të

vogël “Fića<sup>3</sup>” e i dërgojshin nëpër fabrika për punëtorët mos me e lan punën, mos me ardh te na, si ambullantore ashtu shkojshin i merrshin kërkesat i dërgosjshin çertifikatat, mirë ka funksionu krejt kjo deri ‘81-shin, në ‘81-shin ndodhi ajo çka ndodhi me ju thonë të drejtë pak u ashpërsu situata u bo vështirë po e përballuam disi deri në ‘82-shin, në ‘82-shin më kaloi mandati përsëri u ktheva në gjykatë. Fillimisht në Gjykatën Komunale e pastaj në Gjykatë të Qarkut si gjyqtare për të mitur edhe penale. Po thom në Gjykatë të Qarkut ka pasë mjaft landë serioze, vrasje, aso kohe ka qenë edhe ligji i Kosovës vrasje nga gjakmarrja, po...

**Fitore Rexhepi:** A ka qenë problem me i trajtu këto raste me gjakmarrje se zakonisht në mes veti kanë bisedu nëpër oda...?

**Besa Krajku:** Po, po vrasja nga gjakmarrja ka qenë rast... çka me thonë, rast familjar më tepër, nuk ka qenë problem por ka qenë e dhimshme, ka qenë e dhimshme.

**Fitore Rexhepi:** A ka pas në Prizren?

**Besa Krajku:** Ka pasë më tepër në rrethinë, une rastet që i kam pas ma tepër në rrethinë, po kurrë s’kemi pas vrasje enigmatike ta quajmë ashtu, se ata që e kanë kry veprën penale ata është dasht ata kanë pas dëshirë edhe me pranë edhe me tregu se e kryva një obligim në atë kuptim a din, ajo obligim po qe qashtu. Kërcënime s’kam pas kurrë gjatë punës, po jom mundu me landën, e kam përgatit landën mirë, jam mundu me i trajtu të gjitha palët njëjtë, mos me e ndi pala atë... Kështu që, kështu që edhe pala kur e ka pa që ti po angazhohesh me mish e me shpirt a din atëherë, unë mendoj se kam kalu mirë skam pas probleme.

**Fitore Rexhepi:** E qysh i kanë pranë ligjet atëherë se deri atëherë ligjet...?

**Besa Krajku:** Ligjet atëherë, unë po të tregoj ligjet kanë qenë të Kosovës, kemi pasë edhe ligje në kuadër të federatës e kemi pas Kodin Penal të Kosovës, e kemi pas Kushtetutën me ‘74-shin, e kemi pas Kushtetutën e Kosovës edhe muj me thon që ajo ka qenë periudha ma, ma e ndritshme e jona, më e ndritshme unë e kam pasë fatin bash qatëhere me hy edhe në punë. Deri sa kam qenë studente... Po kaloj prej temës në temë por po më nxitni [i drejtohet intervistueses](qeshje). Po më kujtohet fakulteti në juridik, vitin e parë e kemi pas profesorin prej Shqipnisë e Drejta Romake [lëndë e Fakultetit Juridik] ajo ka qenë kënaqësi me i përcjellë ligjeratat kur vishin, se aso kohe kishte Kosova marrëveshje me Shqipninë, këmbeshin profesorët mes veti, po kështu që...

Deri sa kam qenë në kuvend më ka ngel në kujtim edhe njëqind vjetori i Lidhjes së Prizrenit, është festu me 10 qershor të vitit 1878 ka qenë një organizim i hatashëm, i mrekullueshëm. Aso kohe mendoj se kryetari i këshillit organizativ ka qenë doktor profesor Pajazit Nushi me punë ministër ka qenë, minisër i arsimit, kulturës, kështu që kemi bashkëpunu shumë në atë kohë se kishim nevojë me bashkëpunu për arsye se u punojke u kryeshin punimet në objektin e Lidhjes këtu ku ishte, e më kujtohet se në atë objekt banojshin disa skamnorë e mandena atyne ju caktum banesa u renovu ai

<sup>3</sup> Lloj i automjetit Zastava 750 i cili është prodhuar nën licencën e Fiat-it.

objekt...

**Fitore Rexhepi:** Ajo pjesa që është afër Lidhjes apo ?

**Besa Krajku:** Afër Lidhjes ato shtëpiza ajo...

**Fitore Rexhepi:** Muze tash...

**Besa Krajku:** Po të muzeut, kanë qenë si banesa kolektive të skamnoreve, atyne ju sigurun banesa mandej na e renovuan ka pasë mjaft punë aty...

**Fitore Rexhepi:** Domethonë për njëqind vjetorin u bo ajo ?

**Besa Krajku:** Ajo u bo krejt për njëqind vjetorin, po edhe Agim Çavdërbasha i pat punu ato punimet e Ymer Prizrenit e... E më kujtohet atë natë për herë të parë në Kosovë u interpretu opera shqipe “Goca e Kaçanikut” e kompozitorit profesorit Rauf Dhomi edhe në orën tetë domethon 20 në mramje ka qenë transmetimi, po ka fillu ceremonia në Qendrën Sportive, ka qenë transmetimi direkt në krejt Jugosllavinë, prej Sllovenisë deri në Prishtinë, me të vërtetë ka qenë një organizim shumë i mirë.

Po mandej pas ‘81-shit pak flluan me u zbeh, mandej e formuam na, ky me Muhamet Shukriu, Pajazit Nushin, profesor Rizvanolli ashtu paralel diçka u mendojshim me... atë ditë e shenojshim Përparim Kosova, Lule Goranci ishim një grup kështu që na nuk u ndajshim vazhdimisht punojshim atë ditë e shënojshim mandej na objektin e kishim të Lidhjes së Prizrenit u mendojshim me e mbajt me...

**Fitore Rexhepi:** Prej nga ka pas mysafirë, a ka pasë prej shumë vendeve për njëqind vjetorin?

**Besa Krajku:** Për njëqind vjetor ka pas prej të gjitha trojeve shqiptar dhe prej krejt Jugosllavisë, me ju thonë të drejtën me të vërtetë ka qenë një organizim madhështorë.

**Fitore Rexhepi:** A kanë shkru mandej gazetata?

**Besa Krajku:** Kanë shkru si s’kanë shkru, kanë shkru mjaft por tash detajet nuk më kujtohen vetëm e di që ka qenë një organizim i mirë ndoshta pak edhe u bo si njëfarë hallk pengese për diken por u kry ajo u kry me shumë sukses, atëherë me shumë sukses u kry edhe la gjurmë edhe sot e asaj dite ajo ditë shejohet [shënohet], festohet.

## Pjesa e dytë

**Besa Krajku:** 43 vite kam punu, muj me thanë profesionin tim. Pas penzionit pushova gjashtë muj’, jam penzionu me 17 maj 2017-shit edhe vendosa përsëri mu kyç n’këtë profesionin tim. Është hera e dytë që jam regjistru si avokate, herën e parë ka qenë viteve ‘90-ta kur e lamë punën, u bë e padurushme, u bo vështirë me punu në ato kushte, në ato rrethana, me ato ligje. Kështu që u tërhoqëm, nuk ka ngel asnjë shqiptarë në gjykatë. Pak ndejtëm mandejna u bona avokat, m’kanë



përkrah vllaznit shumë në aso kohe, thanë, “Shko ku janë kolegtë, na t’financojmë, na t’përkrahim, ku janë t’gjithë rri edhe ti me ta”.

Fillim nuk kishte punë, po mandej fillun me mbyll [burgos] njerëzit, njerëzit e pafajshëm fillun me i mbyll, nëpër shtëpia me i marrë. Më kujtohet rasti i Rahovecit, në 2000 e... n’98-shit po nejse ka qenë muji gusht. Dëgjum se masakër ka ndodh në Rahovec. Isha n’zyre masdite, një gru e ulur te shkalltë, po e kërkon fëmijnë, nuk po din ku e ka, po e pys, “A ke qenë n’spital?”, tha, “Nuk asht”. “A ke qenë n’morg?”, “Nuk osht”. Thashë, “Atëherë paske fat se nuk osht n’morg nuk osht n’spital, atëherë e ki gjallë, e ki n’burg”. “Por si me e kuptu?”.

Thashë, “Ma jep një autorizim”, ma autorizoj, shkova edhe e veta, me t’vërtetë ishte n’burg. Gëzimi i sajna që o’gjallë. Kështu që fillun mandej me ardh edhe tjerët se ajo kishte përcjell në Rahovec. Kisha autorizim për një grup t’madh të persona t’cilët ishin paraburgim. M’i ju ndihmu shumë nuk mujshim profesionalisht se këta kishin vendos me i marr, me i gjyku.

**Fitore Rexhepi:** Me çfarë arsye i merrshin?

**Besa Krajku:** Po si terrorista, nëpër shtëpia i kishin mbledh njerëzit. Mirëpo mbajsha kontakt me ta, me familje, iu çojsha barna, iu çojsha tesha edhe filloi gjykimi i tyne. Grupi i parë ka qenë diku katërdhetë prej tyne, kur i sjellshin n’gjykim ka qenë tmerr, t’lidhun.

**Fitore Rexhepi:** Cilën moshë?

**Besa Krajku:** Moshë t’ndryshme, po t’miturit, ndahem i mbajshin, procedura, ligji për t’mitur. I sjellshin me autobus deri afër n’oborr t’gjykatës t’lidhun me zinxhir për mos m’i... edhe n’sallë t’gjykimit. Ne ishim t’interesum mos m’u kry gjykimi, këta vazhdojshin me kry gjykimin se u afroke 23 marsi ‘98-shit edhe kishim shpresa mos po ndodh diqka e mos, s’mund t’fillojshe, po nëqoftëse kryhet gjykimi atëherë i dërgonin n’burgje t’Sërbisë. Dikund dy-tri ditë para 23 marsit, para intervenimit t’NATO-s ishte e caktume shqyrtimi kryesor, seanca n’sallë, i sollën këta, qashtu t’lidhun me zinxhir kambt’.

**Fitore Rexhepi:** A u kanë e drejtë qashtu?

**Besa Krajku:** S’u kanë e drejtë, çfarë e drejte, por...

**Fitore Rexhepi:** S’kanë qenë përmbi neve.

**Besa Krajku:** Ata u sillshin me ata si t’ishin terrorista se i ndjekshin për vepra penale, për terrorizëm kundër-revolucion edhe n’sallë gjykimit ishim, ishte shumë kishte, t’akuzum katërdhetë, ne katërdhetë avokatë afër, trupit gjykues. Koleg i jonë, avokat, ai ka qenë paraprakisht prokuror, s’kishte vend ku me ndejt se n’kamb rrishim edhe pak si n’anën prokurorit. Prokurori ishte prej Beogradit, kryetar i trupit gjykues qishte i Beogradit edhe anëtarët e trupit gjykues, m’duket se ishin vendor, gjyqtarët. Ai prokurori, kryetari i trupit gjykues iu drejtu me ton nënçmues avokatit, ish-prokurorit e tha, “Nuk e ki vendin aty”.

Edhe një koleg i jonë avokat, tash i ndërë është Muharrem Skenderi, shfrytëzoi rastin, tha, “Ai ka qenë prokuror edhe përsëri ka me qenë prokuror, po ju atëherë s’keni me qenë këtu”. Ai iu kthye me ton t’ashpër këtinë, e kërkun përjashtimin e gjyqtarit se është subjektiv edhe nuk është real për përjashtimin e gjyqtarit duhet me vendos kryetari i gjykatës. Kërkun edhe përjashtimin e kryetarit t’gjykatës, dojshin me fitu kohë që mos t’kryhet gjykimi edhe le t’ngelin n’Kosovë, u duke ma sigurt me ngel n’Kosovë kështu që u shty gjykimi. M’kujtohet se i pari ishte Muharrem Skenderi, i dyti n’rradhë ishte Iliri, Bajram Kelmendi, atëherë e lëshum na sallën.

Në mënyrë protestuese dulëm t’gjithë. T’u dal, unë pak si ma e reja, ashtu, thojsha, “Mos pranoni avokatin sipas detyrës zyrtare”, se u frigojsha e caktojnë avokatin për detyra zyrtare edhe e kryen gjykimin edhe i dërgojnë. Kështu që, në qat shpejtësi u nguta e morra edhe një leje, shkova edhe ja përcjella veç klientit tim që mos t’pranoj caktimin e avokatit sipas detyrës zyrtare me shpresë se do t’prollongohet diçka. Ajo osht hera e fundit kur jam taku edhe me Bajram Kelmendin, mo. E dini mandej mbas tri-katër dite, po m’duket se ato me fëmijë e vranë. Ndodhi ajo çka ndodhi, u mundova me bo kontakt me to ishte e pamundun edhe pse gardianët kishim shqiptart n’burg, këtu ka pasë gardienë shqiptarë edhe ka qenë qëndrimi mos me e lëshu ata punën mu për hir të njerëzve që ishin brenda por edhe pak... Se femnat, lufta filloi, femnat dilshin edhe unë u mundosha me dal edhe dilsha. Erdha dej këtu po s’kisha informatë, po thanë ende janë këtu n’burg, nuk i kanë dërgu askund.

**Fitore Rexhepi:** Kanë qenë n’Kosovë apo?

**Besa Krajku:** N’Kosovë kanë qenë, po. U ktheva...

**Fitore Rexhepi:** N’cilin n’vend n’Kosovë?

**Besa Krajku:** Po qëtu Qendra Paraburgimit e Prizrenit që ka qenë, po këtu ka qenë një grup. Një grup n’Lipjan, një grup, mirëpo këta... e edhe diçka harrova. T’miturit që i kisha une, deshti fati i lirun para fillimit t’intervenimit. Ka pasë atëherë lloj-lloj shoqata t’ndryshme humanitare erdh një femër prej Amerikës, m’duket se Barbara ka qenë, Barbara s’m’kujtohet mbiemri veç shkun i vizitun edhe mandejna trysni ju banë edhe i lëshun këta t’miturit domethanë moshës nën tetëmbëdhjetë vjeç. Njëri prej tyre m’kujtohet erdhë në zyre te unë, ka qenë i fshatit Mohlan edhe ma s’kom ndi për te.

Kom pyt shumë, por nuk e di çka ka ndodh, me të, atëherë. Derisa isha avokate m’kujtohet se edhe n’Vrraniq patën ndodh njisoj masakër. I patën pru, i patën sjell me kamion ata, edhe aty hynë vullnetarisht. Në rastin e Rahovecit edhe n’rastin e Vrraniqit ne avokatët jemi organizu vullnetarisht pa kurrfarë kompenzimi. Kemi shku i kemi mbrojtë, kemi mbajt kontakt me familjen edhe kur ndodhi lufta, sa kemi mujt me pas kontakt me ta. I kemi kontakt, ka qenë qëndrimi jonë, qashtu me kontribu. Po gjatë luftës, unë mendova se me mu nuk kanë punë, nuk jam marr me politikë, me profesion jam marr mirëpo me politikë nuk jam marr.

Edhe si gjyqtarë, si gjyqtarë nuk kishim edhe t’drejtë edhe tash nuk osht e preferume gjyqtari me qenë anëtar i partisë politike. Mirëpo ja që ja dhanë me m’dëbu edhe m’thanë se jam e padëshirushme edhe duhna me lëshu shtetin. U befasova, prita se kanë me m’dëbu për shkak t’punës si avokat, mirëpo kur ma përcollën atë porosinë, thanë se jam e padëshirushme edhe m’thanë, “Zoja gjyqtare...” thashë, “Unë nuk jam gjyqtare, jam avokate”, “Jo, gjyqtare je”, e kështut. S’disha ka me shku, çka ndodhi.

Menjëherë u mundova me kontaktin me disa kolegë se majshim në kontakt, mos edhe avokatë tjerë. Isha e para prej avokateve e cila u dëbu.

**Fitore Rexhepi:** Për çfarë arsye?

**Besa Krajku:** E padëshirueshme.

**Fitore Rexhepi:** Vetëm qekaq?

**Besa Krajku:** Qaq, e padëshirueshme je. Thanë, “Na vimë me vërtetu a jeni këtu, a s’jeni këtu?”. Atëherë një koleg tha, “Ti sonte vjen te une, nuk rrinë, kërkim nesër”, tha, “Për me t’largu prej këtuhit, s’guxon vetëm me dal”. Se atëherë ishin do lista t’personave t’cilët ata i vlerësojshin si, o t’rrezikshëm, o t’padëshirueshëm, për arsyet e tyre, kështu që tha, “Nesër”. Por t’u qenë unë te ai, ato e murrën. Kishte dalë para derës edhe e murrën edhe e çunë për n’Shipni. Atëherë unë u largova prej shtëpisë ti, mos me e rreziku as familjen e tina. U strehova te prindt’ e kunatës, shoqës t’vllaut. Ata ishin pleq vetun. Ata m’kanë majt dy muj’ ilegal ashtu. Kërkush s’m’ka pa.

**Fitore Rexhepi:** Cili vit ka qenë ky?

**Besa Krajku:** Ky ‘99shin, ‘99-shin. Domethanë une dy muj kam nejt, n’dhomë e mbyllun, fare s’kam komunikuar. Edhe kërkush se ka ditë, përveç tyre, kërkujt s’i kanë tregu. Se u frigojsha mos po i rrezikoj edhe ata. Mandej dikush e çoj lajmin që ka me ardh kontrolli ashtu me ma ndërru vendin prej atyhit deri me thanë fundin e luftës e kam prit, jam kthyer mandej përsëri te ta, n’shpinë e tyre. M’kanë rrujt prindt’ e shoqës t’vllaut. M’kujtohet kur kanë hy forcat e NATO-s. Atëherë atmosfera atje se ishte, banesa e tyre ishte n’skaj rrugës n’Bazhdarhane. M’kujtohet ai gëzimi ka dulën ata njerëz, qysh zbritën prej ballkonit, se ato banesa u mbyllshin me çelës, unë nuk e di. Çfarë shpejtësie veç e di, qysh i kanë prit me lule, natë ka qenë, diku ora nimdhetë e natës. Nejta aty se kisha marrë disa, kisha marrë si një shqetësim, si s’di, isha mësu ashtu mos me komunikuar me njerëz, mos me fol. U frigojsha mos po e rrezikoj dikund. Erdha mandej n’shpi. Dikund me gjashtëmdhjetë apo me pesëmdhjetë korrik erdha, e qaj kolegu, thash qat ditë n’sallë që e tërhoqi vërejtjen e gjyqtarit që s’je prokuror, erdhi me m’njoftu se ai, unë edhe një koleg tjetër, jemi zgjedh tre prokuror në Prokurori të Qarkut edhe shtatë gjyqtarë edhe betimi ishte t’nesërmen. Po thom në qasi shpejtësie ndodhshin, gjanat nuk e dishim çka po ndodh. Shkum, u përgatitëm, erdh Kushneri<sup>4</sup>, u betum, fillim me punu fillimisht si prokurori emergjent.

**Fitore Rexhepi:** N’cilin asht ky?

**Besa Krajku:** ‘99-shin, ‘99-shin. Meniher me 17 korrik na jemi betu edhe meniher kemi fillu me punu. S’ka qenë lehtë, mirëpo na ka majt vullneti. M’kujtohet landa e parë, aktakuza e parë, erdhë një përkthys, se atëherë s’kemi pasë, polici, KFOR-i ishte, lujke rolin e policisë, e kishte një përkthys dhe i tregojke atij se çka ka ndodh ai e përkthejke edhe na shkruajshim edhe kryesorja qajo aktakuzë u vërtetu, domethanë u vërtetu ngjarja në fund mas një kohe, kur e kam pa atë landë, shumë n’rregull ka

<sup>4</sup> Bernard Kouchner, përfaqësues special i Kombeve të Bashkuara, Shef i UNMIK-ut.

qenë. Edhe pse qato kushte, qato rrethana, s'kishim as mjete t'punës. Mirëpo kishim vullnet, kishim vullnet t'gjithë, t'gjithë kishim vullnet, kemi punu shumë.

**Fitore Rexhepi:** N'çfarë sistemi keni punu, n'çfarë ligje?

**Besa Krajk:** Ligjet kur fillum me punu, u bonë problem, jo problem ligjet, po ligjet n'fuqi, ligjet n'fuqi ishin, ligjet e Sërbisë ashtu, se këta kur e suprimun kuvendin edhe ligjet e Kosovës si..., mandejna Kushneri na thirri një mledhje ai e hudhi poshtë, ligje diskriminuese ka pas, n'mesin e atyre ligjeve edhe diskriminuese, sa i përket çështjeve pronësore. Mirëpo edhe rregullorja na mundësojke neve mos me i zbatu, automatikisht ligjin diskriminues mos me e zbatu. Kështu që ai na kthej në ligje të '89-shit domethënë kur kanë qenë n'fuqi ligjet.

Erdh një Kushneri njëfarë modifikimi ashtu boni, i hudhi poshtë t'gjitha ligjet diskriminuese mos zbatohen, e ligjet t'cilat nuk janë diskriminuese t'zbatohen. Ndërkohë mandej na u formun ekipet për hartimin e ligjeve. E di se ka pasë mjaft problem atëherë, do s'dojshin me punu, do, shumë e arsishme, mirëpo ligji nuk, për një ditë nuk, krijohet, kështu që kadalë-kadalë punun komisionet, punun komisionet edhe definitivisht me 2003-shin, po m'duket po, kodi penal edhe kodi i procedurës penale Kosovës o' pru.

Ndërkohë na nuk i zbatojshim ligjet diskriminuese, kryesisht punojshim penale, vrasja, ishte vrasje, e qëto. E n'vitin 2000 mandejna u themelun edhe gjykatat komunale se në '99-shin ishin këto emergjente gjashtë muj' edhe prokuroria edhe gjykata ishin si gjykata emergjente, vetëm për raste emergjente n'atë kuptim po. Se me raste civile nuk punojshim, na vetëm me raste penale, vrasje, këto vjedhje, ka pasë, mjaft vjedhje, ka pasë kalim illegal t'kufirit, me armë ka pasë, çka s'ka pasë, por as orar s'kemi kqyr, as kurgjo, me randësi puna m'u kry, po.

Mandej 2000-shin u themelun edhe gjykatat komunale e mu më emnun kryetare t'gjykatës komunale n'Prizren. Me t'thon drejt nuk aplikojshin, po qashtu e panë t'arsishme, se unë pata vendos me ngel aty ku isha, pata punu gjashtë muj', po ku t'hojshin ashtu. U kthyn punëtorët n'punë përsëri, gëzim, se fillimisht shumë pak kishim punë na, tre prokurorë, gjashtë gjyqtarë edhe personeli. E u kthyn se këta e patën lanë punën '90-shin, nëpër shtëpia administrate kryesisht s'kanë mujt me hap avokaturë, kanë qenë pa punë.

Fillun me punu, me thanë t'drejtë kushtet ishin përsëri t'vështira, pagat ishin t'vogla, mundësia për me punësu ishte shumë e kufizime, se ishte e drejtë e rezervume e UNMIK-ut, s'mujshje ti me sjellë gjyqtarë. Kishim kuadra, s'osht që s'kishim kuadra, po procedura shkojke shumë kadale edhe sigurisht edhe lejimi i mjeteve. Kështu që me tetë gjyqtarë fillum, prej tyne penale, vishe me caktu civile, ekzekutime edhe ngelëm, si me thanë afro tetë vite me tetë gjyqtarë. Çdo muj' bojsha presion, kërkojsha, por pak ka shku edhe u akumulum problemet edhe pse muj' me thanë se Gjykata e Prizrenit ka qenë një ndër gjykatat ma azhure aso kohe se edhe populli n'Prizren asht ma i ngritun, nuk e preferon vetëgjyqësinë.

Për zgjedhjen e problemeve juridiko-pronësore i drejtohet gjykatës edhe çështja e trashëgimisë n'Prizren kahere asht zgjidhë edhe zgjidhet edhe realizohet edhe i drejtohen, me kërkesa t'gjykatës. Kështu që deri n'vitin e dhetë kam qenë në Gjykatën Komunale si kryetare e gjykatës. Mandena u bo i

riorganizimi i gjykatave. Unë kalova mandej në n'Prishtinë, m'vdiq edhe një vëlla, vëllai i katërt me rradhë, kemi qenë shumë të afërt. Ndërrova pak edhe, ashtu ndoshta edhe rrethin e... Fillimisht isha n'prokurorinë e qarkut, n'Prishtinë. Mandej n'prokurorinë e krimeve t'randa kam qenë, kur edhe jam pensionu, deri n'fund kam punu n'Prishtinë.

**Fitore Rexhepi:** A ka qenë e rrezikshme për prokurori, a keni dalë n'terren?

**Besa Krajku:** Kam dalë n'terren, kam dalë n'terren, për çdo vjet kam dalë n'terren, për çdo vrasje kam dalë n'terren, n'vend të ngjarjes se duhesh me siguru vendin e ngjarjes. Provat, provat e para nëse nuk ruhen, nëse nuk sigurohen atëherë shumë vështirë, mandej edhe me ndriçu rastin. Ka qenë vështirë, me ju thanë t'drejtë, por s'osht punë që s'kryhet, kur don ekip punojshim, bashkëpunojshim edhe policia t'ndihmojke edhe vetë edhe... Kujdestaritë kan qenë shumë t'randa se një javë ishte 24 orë kujdestare.

Prishtina ishte një qendër ma e madhe, e ma shumë probleme. Çdo rast që ndodhke gjatë kujdestarisë e cila i përkiste kompetencës krimeve t'randa lajmrojke policia edhe u dujshe aty për aty me dhanë, menjëherë instruksione se polici punon me instruksione t'prokurorit. Prokurori i jep instruksione çka me bo, tek me bo, kështu që fizikisht ka qenë e lodhshme, e lodhshme, por u kry.

**Fitore Rexhepi:** Sa vjet keni punu n'prokurori n'Prishtinë?

**Besa Krajku:** N'Prishtinë kam punu prej 2011-shit deri n'pensionim 2017-shit. Ka do raste që m'kanë ngel ashtu pak ma, ma specifike që ka qenë, por vrasja e fundit, bilem dy ditë para se me pensionu kam qenë, e kam profesu një vrasje, një polic e patën vra n'detyrë. E s'arrita me kry, zgjati, masi ishin shumë, 8 t'akuzum ishin, e m'kujtohet se edhe dy ditë para pensionimit kam qenë, e pata lut atëherë, thashë mu po m'afrohet koha e pensionimit, ju lutem një prokuror le të m'përcjell gjatë punës, ta kom ngat, mandej do ta ket ma lehtë m'u kyç. Por ja që s'ndodhi ajo, kështu që e lashë landën.

**Fitore Rexhepi:** Mandej e kanë vazhdu dikush tjetër?

**Besa Krajku:** E ka vazhdu, po, e ka përfundu një koleg, e ka përfundu një koleg.

**Fitore Rexhepi:** Ju keni punu me dy sisteme, para luftës edhe mbas luftës, qysh ju ka dok këto dy sisteme t'cilët, qysh kanë ndiku te ti? Sa ka qenë e vështirë, mandej ky sistemi i ri i rasteve gjyqësore?

**Besa Krajku:** Ju thash gjyqtari e zbaton ligjin, nuk sjell ligje. Kemi qenë n'presion para luftës, kemi qenë n'presion edhe pse e zbatojshin ligjin vazhdimisht ishin n'mbikqyrje, ishte ajo pasiguria, ishte ajo frika, por unë mendoj kur je profesionist, kur e ndigjon rastin mirë, kur i ki provat brenda atëherë ki ditë edhe me i liru, ki pa që s'ka prova, e ki liru, e ki studiu landën s'ke pas problem. Unë për veti s'kam pas problem, ndoshta edhe kam pas fat edhe kam punu me t'mitur, ligji te t'miturit ka qenë shumë human. Te t'miturit aso kohe edhe tash nuk ka dënim me vdekje, por aso kohe për t'rriturit ka pas edhe dënim me vdekje për vepra ma t'randa penale.

Te t'miturit dënimi maksimal ka qenë 10 vite, o i boni një vepër, domethanë se te këta, nuk ka pasë mbulim t'veprave, me një dënim u dënoke edhe atë dënoke i mituri i rritun, domethanë ai i cili i ka mbi gjashtëmdhjetë vite. Deri gjashtëmdhjetë vite vetëm masa edukuese u shqipojshin. Mandej te t'miturit

punojnë ekip, i kishe anëtarët e kolegjit porotë, kryesisht punëtorët e arsimit, t'penzionum ose n'punë, pedagogë, qendra për punë sociale, prindin. Kështu që ishte një ekip edhe ma tepër ishin seancat edukative sesa të quajmë ashtu gjykuese. Unë po thom ka ndoshta ka qenë edhe fati jem që kam punu me landë të tilla edhe dënimet nuk kanë qenë t'larta.

**Fitore Rexhepi:** I keni përmend ma herët edhe rastet me gjakmarrje, a ju kujtohet naj rast?

**Besa Krajku:** Po, po m'kujtohet rasti. M'kujtohen nja dy, tri raste, po rasti që unë kam qenë kryetare e trupit gjykues, diku '87-shin ka qenë vrasja nga gjakmarrja, mbas pesëmdhetë viteve e ka kry. Te këto vepra zakonisht nuk e kishin problem identitetin e të akuzuarit se pranojshin, vetë e pranojshin, normal dëgjimi, dëshmitari e krejt. Qëllimi i mbrojtësve atëherë ishte veprën me e shndërru si mbrojtje të nevojshme ose tejkallim i mbrojtjes t'nevojshme a din, normal për shkak se dënimet ishin shumë t'randa te vrasja nga gjakmarrja. Por ja që provat ishin t'tilla se me t'vërtetë ky ishte pregatit viktima nga rasti shpesh e kish provoku, po ky nuk kishte reagu në ato vende.

Kështu që nuk mujsha atë kualifikimin e avokatëve tyne me e pranu se asht vrasje n'çast ose ka qenë i provokum se n'ato momente ky nuk ka reagu. M'kujtohet se nimdhetë vite patëm, po nimdhetë vite dënim, se kishte shumë rrethana lehtësuese, kemi dëgju shumë dëshmitarë. Ishte një person i shkëlqyeshëm, nuk kishte t'kalume kriminale. Tani na ka shku me ankesa mandej, mendoj se asht vërtetu aq sa ka, sa e ka pasë dënimin, minimum ishte dhetë vite, domethanë nimdhetë vite, përndryshe maksimumi aso kohe ishte njizet vite, pastaj dënim me vdekje. Po n'qoftëse i jepshe dënim me vdekje mujshë me zavendësu me njizet vite dënim. Dënimi me vdekje u shfuqizu po m'duket se para luftës. Kështu që na kur fillum me punu mas lufte mo s'kishte, nuk kishte dënim me vdekje.

**Fitore Rexhepi:** A ka pas raste kur i ke pa mandej personat që i ke akuzu ose...?

**Besa Krajku:** Po, po, po shpesh gjatë kom punu, po unë po thom gjatë tanë kohës, gjatë seancës kom komunik, jam mundu me qenë n'nivel professional, tu e respektu dinjitetin edhe t'akuzumit edhe t'viktimës edhe kështu që e kam bind përmes provave, përmes komplet procesit, procedurës. Se ka ndodh ajo që ka ndodh edhe se ligji osht ai i cili t'dënon jo une. Une për momentin veç jam kon ajo që e ka shpalos shkresat, e kam vlerësu. Por s'kam pas problem, kurrë s'kam pas problem. Normal osht ai hezitimi kaniherë a din, se ai, por jo. Nuk kam qenë edhe n'kontakt kështu që kom bo një jetë pak ma si t'izolume ashtu a din, nuk jam sjell fort n'rreth ashtu. Jom sill n'vend t'caktun, rreth njerëzve t'cilët nuk kanë fort n'kontakt me krimin kështu që, mirëpo nuk kam pas problem.

**Fitore Rexhepi:** Përveç punës qysh ka qenë jeta n'qytet, qysh e keni kalu, pjesën tjetër t'rinisë?

**Besa Krajku:** A jeta n'qytet! Pjesën e rinisë, po thom po flas për atë pjesën pak ma shkollën e mesme ma tepër a din, kam kalu n'Prizren me shoqni. Kemi banu n'qendër afër kino "Lumbardhit", aty e kemi pas shpinë. N'krahësim me qytetet tjera Prizreni ka qenë qytet ma i emancipum, kishim kusherina t'Pejë, t'Gjakovës edhe gjithë kishin ka një t'gjeneratës prej kushërive kështu që vishin gjatë verës. Korzon e kemi pasë, ka qenë Theranda atëherë, terras ka pas, muzikë, po verës, një ambient shumë i mirë. Na me prindt kemi qenë mjaft afër, nuk kemi pas pengesa, se atëherë pak femrat nuk mujshim

me dal, mirëpo nuk kemi pas, kemi pasë lirinë e plotë n'atë kuptimin me shku me shoqni, n'korzë me dal. Edhe shoqet i kom pas n'qat pozitë kështu që qato shoqet e...

**Fitore Rexhepi:** A u kon naj kohë e caktune kur keni dal n'korzë?

**Besa Krajku:** Po n'mramje n'korzë normal e kemi pasë kohën e kufizune me nejt vonë s'kemi nejt, ajo o' ditë, kështu që ka qenë rregull, ashtut edhe kemi zbatu atë rregull, e kemi zbatu atë rregull.

**Fitore Rexhepi:** A ka pas filma n'kinema?

**Besa Krajku:** Ka pas njiherë n'javë. Na banojshin n'qendër, unë isha e autorizume prej shoqnisë, prej shoqeve me shku me marrë biletat edhe n'orën tre ditën e diell njiherë n'javë shkojshim n'film.

**Fitore Rexhepi:** Qysh e ka pasë emrin kinemaja?

**Besa Krajku:** Po m'duket se Kino "Bistrica" i thojshin, po m'duket edhe ka qenë Kino "Rad", tash që osht te "DokuKino", po Kino "Rad". Aty ka qenë edhe shtëpia e sindikatit t'punëtorëve, po m'duket qështu. Besa edhe n'shköllë na çojshin kajherë n'filma neve. Komplet klasën na dërgojshin n'filma, për Vitin e Ri shkojshim n'film.

**Fitore Rexhepi:** Çfarë filma ka pas ma s'shumti?

**Besa Krajku:** Paj filma qesi "Tre musketarë" e qësi filma, mandej na fillun do filma indiane edhe ka pas, thojshin zhurnall, atëherë ishin si lajme tash, a din, ato udhëtimet e funksionerëve e qështut i jepshin pjesën. Vitat e Ri i pritshim n'film, i jepshin kah dy tri filma, mandena u bojke pritja e Vitit t'Ri n'orën dymdhetë, u ndërprejke, u bojke si nji pushim, me prind shkojshim, me shokë t'babës. Vazhdimisht kemi qenë me shoqni edhe me prindt' e tyne kështu që fëmijët e shokëve t'prindëve, jemi shoqnu domethanë, prindt' e kanë ditë çfarë rrethi po sillem edhe ajo ka ngel deri tani, na ka ngel.

**Fitore Rexhepi:** N'teatër a keni shku a ka pas shfaqje?

**Besa Krajku:** S'ka pasë fort teatër, s'ka, barem [të paktën] unë nuk e di, s'ka pasë fort. Unë s'kom qenë kumedit sa edhe ashtut. Fëmija i dytë kom qenë n'shtëpi, na pesë fëmijë, kështu që si fëmijë i dytë, por isha pak e zhvillume për moshën teme mbinte pak para rolin e nanës me e zavendësu pak se nana ka punu mjaft punëdore kur u bonëm ne gjithë studime, me t'vërtetë ishte vështirë për familje. Kështu që ka punu mjaft punëdore.

**Fitore Rexhepi:** Qysh e sheh qytetin tash?

**Besa Krajku:** Qysh e, kur shkova n'Prishtinë m'preferun m'thanë, "Pse s'po shpërngulesh n'Prishtinë?". Thashë, "Jo, le ta kaloj pleqinë aty ku m'ka kalu jeta". Prizreni osht nji qytet i mrekullueshëm. S'ka ndryshu shumë, s'ka ndryshu shumë, ndoshta komunikacioni përndryshe, shadërvani osht ç'aj. Po tash ka ma tepër qarkullim, s'ka pas automjete, shkojshim te Centrala. Baba na merrke me veti me bicikletë shkojshim mu la. N'kala shkojshim kur na vishin mysafirtë prej Pejës, ata kanë pasë shumë merak me shku n'kala, i çojshim n'kala.



E kanë deshtë Prizrenin gjithë e kanë deshtë, prej kushërive gjithë e kanë deshtë. Vishin fëmijët e hallës edhe t'tezës, tanë verën e kalojshim këtu. Përpara autobusa ka pas rrallë, s'mujshe kur t'don. M'kujtohet ishte dita e fundit, kishin me udhëtu atë ditë edhe djali i hallës nuk po han drekë. Po e pyt nana, "Pse s'ke hangër drekë?", "Po frigona inxhe<sup>5</sup>", tha, "se Lulja ka biletën n'orën katër, mos po pendohet pe kthen biletën e po bun një natë ma shumë se unë". Domethanë qaq ishte ajo afërsia, a din vishin, qaq e dojshin Prizrenin edhe unë mendoj se osht, osht qytet për t'u dashtë.

M'pëlqen edhe mentaliteti i Prizrenit, jam rrit n'Prizren. Po tham, e ndi veten prizrenase. Dikush m'tha, "Po ti babën gjakovar", kosovare jam, por jam rrit n'Prizren, m'pëlqen mentaliteti i prizrenasve, janë njerëz me një kulturë. Tolerancë ka, bashkëjetesa asht n'Prizren n'krahasim me vendet tjera, mendoj se asht nivel mas niveli. M'kujtohet kur erdhën prej Pejës ne nuk dishim turqisht, se na n'shpi kemi fol shqip, e n'rrugë aty ku banojshim te "Farmakosi", ku ka qenë "Farmakosi", kryesisht turqisht flitshin edhe ne s'mujshim m'u inkuadru n'lojë, po për një muj' na e mësum turqishten.

Edhe një ditë mu kujtu, gjuha e lojës ka qenë gjuha turqishtes. Aty kam banu mahallën se atëherë s'kam ditë këto dallimet, ka banu turq, ka banu serb, ka banu shiptarë, mirëpo gjuha e lojës ka qenë gjuha turqishtes, gjithë kemi komuniku bashkarisht. Normal kur kemi hy te dera e oborrit, baba na ka thanë, "Tash prej këtuhit ship brenda" (qeshë). E qekjo osht qajo fëminija, po tham që kur dimrit dilshim me rrshit me saja me... osht kohë e ambël. Ndoshta kemi edhe emocione për shkak se kemi qenë fëmijë, kemi qenë t'mbrojtun prej prindëve, i kemi pas rreth vetit, me kalimin e kohës, po na mungojnë, po pakohem çka osht normal, kështu që, ndoshta edhe kjo osht arsyeja që po na duken shumë t'ambla ato ditë.

Mirëpo ka pas sinqeritet, ka pas ndershmëri, janë ndihmu njerëzit mes veti, unë qashtu po mendoj edhe aty n'punë, kur shkojshe kur hishe, hasshe mirëkuptim meniherë. Çdokush u mundojke me t'ndihmu për, nuk e shihshim si konkurrent njeni-tjetrin, nuk e di tash si asht, por po m'duket se pak ma vështirë osht për rininë. Osht' edhe konkurrenca e madhe dhe mundësitë janë pak ma t'vogla për punësim. Jom mundu me ato mundësitë e mija sa kam ditë, sa kam pasë mundësi. Nuk e kam kursy vetin, mendoj se ja kom dalë.

Kurrë s'kom mendu tan kohën veç t'punoj edhe mos t'gaboj, mos t'a akuzoj dikend pa t'drejtë. Ajo shumë m'ka, kom pas atë ndërgegjen shumë n'nivel edhe jam frikësu prej asajna, s'kam dashtë askend me mbajt ndërgegje. Por kur u penzionova mandej reagimi i kolegëve n'Prishtinë sidomos, se atje u penzionova, mënyra se si ata m'u ofrun atëherë u vetëdijësova. Thashë, "Po unë pasna punu mirë", n'atë kuptim thashë. Kështu që m'kanë një përcjellje shumë dinjitetshme ma kanë bo, pjesë-pjesë. Njiherë ato koleget aty, vetëm prokuroret ku punojshim ato ma bonën një befasi, s'e disha.

Vetëm ato një natë, mandej komplet kolektivi, mandej komplet gjyqtare, prokurore që kanë punu, do që janë penzionu ma herët, do që janë ende n'punë, që jemi njoft se ne s'kemi qenë shumë. Ne jemi njoft krejt mes veti, ashtu jeta na ka lidhë, jo herë n'gjykatë, jo herë n'prokurori, herë nëpër seminare, kështu ne kemi pasë kontakt gjithë mes veti edhe normal, këtu mandej familja ma ka bo ceremoninë.

<sup>5</sup> Emërtim që përdoret për gra më të moshuara në formë respekti.



**Fitore Rexhepi:** Qysh po ndiheni tash e penzionume?

**Besa Krajku:** Po, para pensionimit pata vendos mos mu mërzit me ta thanë [vërtetën] normal se veç e shihshe, i shihsha do shoqe që fillun. Tash sa do t'jem e aftë fizikisht e psiqikisht do të mundona me punu edhe me kontribu edhe mos me lanë atë përvojën huq. Mendoj se njerëzt kanë nevojë, kanë nevojë, mos kurgjo këshilla, m'i ju hap rrugë, se kanë nevojë njerëzit për këshilla se s'po dinë ka kanë me shku a din, është kompetencë. Derisa kam qenë kryetare e gjykatës shumë kam pasë kontakt me popullin, shumë kanë ardh.

E kam pasë ditën e mërkurë, ditën e palëve, edhe vishin vazhdimisht. Shumë raste nuk kanë qenë për gjykatë, ka qenë çeshtja për kuvend komunal, po thjesht pasi që e kam ndëgu e kam identifiku problemin edhe e kam udhëzu ka t'shkon. Normal ajo që ka qenë për gjykatë, jom mundu me mish e me shpirt, veç me e shti n'binarë, le t'fillon, t'ja hekim atë dyshimin që s'ka njoftësi edhe s'po mundet, ajo shumë m'ka dhimbtë me t'thanë t'drejtën, ajo shumë m'ka dhimbtë. Sidomos kur m'vishin gra, njerëz t'moshum, skamnorë kur vishin, a din, jam mundu.

Besa edhe kolegtë, kam pas konsideratë, i ftojsha, i lutsha, a din, u mundojshin se ata edhe profesionalisht kishin problem, s'kishin mundësi materiale me angazhu avokatë, mandej ju dështojshin landtë, kur i dështojke landa, menjihërë ishte ai mosbesimi se me qëllim ma boni ose unë s'kam njoftësi edhe s'kam t'holla edhe a din, kështu që jam marr me qesi gjana ma tepër me thanë t'drejtë, kah fundi n'Prizren s'kam mujt mu marr shumë me punë profesionale. Mirëpo kemi qenë gjykatë model t'përzgjedhun nga USAID-i e aty kam punu edhe arritën domethanë 2010-shin u bo inaugurimi i objektit t'ri, mirë, edhe arhivën po m'dukët se po edhe arhivën.

Kështu që kohë mbas kohe kishe mundësi edhe me punësu qështu t'ri që diplomojshin, këto projekte ishin nji vjeçare edhe me ju thanë t'drejtën gjithë ç'ata t'ritë që i kemi punësu projekte, kemi bo çmos me i nal. Ashtu donte fati u hapte nji vend i punës, dikush shkojke n'pension kështu që shumica prej tyre kanë hi qeshtu.

**Fitore Rexhepi:** A kanë qenë t'përgatitun studentat e ri, qysh ju ka dok juve?

**Besa Krajku:** Neve n'ato kohë nuk, n'aso kohe s'kemi pasë shumë studenta, ma tepër kemi pasë t'diplomum. Pak u vonu komisioni për provimin e judikaturës, kështu që këta i'u mundësojshin, domethanë punojshin për me mujt me fitu t'drejtën me hi në provimin e judikaturës. Ç'ata që i kemi pasë ne kanë qenë mandejna nji shkollë për gjyqtarë a din pranë institutit t'gjyqësisë. Ajo tre muj' ishte, punojshin edhe shkojshin. Ishin referenta, ishin përkthys, ishin jurist, por me provim t'judikaturës, po s'mujshin m'u zgjedh gjyqtarë se për herë t'parë fillun organizimi ishte i tillë që u duhej me e kry ç'atë shkollë për gjyqtarë.

E di se kanë qenë shumë t'mirë se i poentojshin mandej. E m'kujtohet edhe nji rast derisa isha aty më erdh njena, s'e kisha pa shtatëmbëdhjetë vite. Viteve '90-ta patë shku n'Turqi, ishte kthy edhe s'kisha mundësi. Thashë, "Le numrin e telefonit", ama kurrfarë mundsie s'kisha. Atje n'Turqi s'kishte punu n'profesion, i kishte vdek bashkëshorti, ishte kthy këtu, motra pa punë, prindt' vdek, ajo ma la numrin

e telefonit, si dul prej zyrës, m’thirrën prej USAID-it, m’i kërkun dy emra t’juristave. Thanë, “Për dy orë duhesh me na dhanë, e keni fitu projektin për arhivë”.

Po tham, gëzimi jem menjëherë këtë emër e dhashë edhe një emën kështu që pritke që vike me u interesu. Kjo mandejna u tregu shumë e zgjutë. Gjatë rregullimit t’arhivës e përtriu materien, lexoi shumë e dha provimin e judikaturës, shkoj n’shkollë për gjyqtarë, sot osht gjyqtare. Domethanë u kyç, arriti m’u kyç. E qëto janë qato kënaqësitë që i ndinë njeri që ka arrit diçka, e mi ju thanë t’drejtë femrat kanë qenë shumë punëtore, me femra shumë mirë jemi marr vesh. S’kanë kqyr mas lufte, s’kemi pasë pastruse, dilshin vetë.

Vishin m’i ndërru dritaret dilshin vetë, e çojshin e rregullojshim terrenin krejt. Krejt kanë pas vullnet me punu, krejt kanë pas vullnet me punu. Po pakës zgjati shumë ajo status quo-ja me ju thanë drejtë, zgjati pak shumë. Njerëzit hupën durimin.

**Fitore Rexhepi:** A ka edhe diçka për kohën tash, për rininë e tashit?

**Besa Krajku:** Une rininë e njoh përmes rinisë n’familje, kështu unë që mendoj se jeni t’shkëlqyshëm n’këtë kohë, t’pasigurtë për punësim po mendoj, atë vullnetin që e keni se gjithë e krahasoj vetin. Natën kom mësu zakonisht se ditën s’kam mujt shumë me humb kohë, por natën kam mësu. Shpesh m’zinte gjumi e pisha një kafe me u kthjell e me vazhdu, thojsha, “Ma mirë sa ma shpejt që diplomoj qaq ma shpejt hi n’punë, sigurona”. E tash kur po i shoh rininë sa po kanë punë, sa po kanë po thamë, “Prej nga vullneti?”, se s’po kanë fort shpresa, po m’duket, po asht pak për punësim problem edhe krejt n’këtë situatë me gjet vullnet me ngajt unë mendoj se janë t’shkëlqyeshëm. Ai osht mendimi jem janë t’zgjut, janë t’mençëm.

**Fitore Rexhepi:** Faleminderit shumë për kohën!

**Besa Krajku:** Faleminderit prej juve!